

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, përmes gjyqtarës së vetme gjykuese Snezhana Mihajloviq, me sekretaren juridike Suzana Kovaçeviq, në lëndën penale kundër të akuzuarit I.S. nga Gjilani, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr.6 lidhur me paragr.1 KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.2340/2017 të datës 13.12.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më dt. 19.09.2018, në prezencë të palëve publikisht shpalli

A K T G J Y K I M

I akuzuari **I.S.** nga babai B. dhe nëna A.-B., i lindur më dt. ..., në Gjilan, ku edhe jeton, rr. e“ ... ” pn., i martuar, baba i dy fëmijëve, i arsimuar, ka të kryer shkollën e mesme, punon në qeramikë, i gjendjes së mesme ekonomike, deri më tani i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për veprën tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

ËSHTË FAJTOR

Sepse më dt. 08.12..2017 rreth orës 08:30 minuta, në Gjilan, në rr. “Ramiz Çërrnica” i pandehuri nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik duke e vë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, ashtu që duke drejtuar automjetin e markës “Mercedes Benz” ngjyrë e kaltër, me targa të regj. ... ka vepruar në kundërshtim të dispozitës ligjore të nenit 41.1 të Ligjit mbi Rregullat e Trafikut Rrugor të Republikës së Kosovës, në atë mënyrë që duke lëvizur në drejtim të rrugës së Prishtinës, me të arritur përballë “Arena Fitness” me qëllim të ç’kyçjes nga komunikacioni, bën kthim të pasigurte majtas, ku me pjesën e përparme të anës së majtë ndeshet me anësoren e parë të anës së majtë të automjetit të udhëtarëve të markës “VW Golf” me targa të regj. ... të cilin e drejtonte i dëmtuari B.Sh., i cili ishte duke lëvizur në drejtimin e kundërt dhe del jashtë rrugës në anën e djathtë të lëvizjes dhe me pjesën e përparme e godet reklamën “Arena Fitness” me ç’rast shkaktohet aksident trafiku me dëme materiale dhe lëndime trupore, ku lëndime trupore pëson i dëmtuari B.Sh. i cili kërkon ndihmën mjekësore në emergjencën e Spitalit e Përgjithshëm në Gjilan dhe po të njëjtën ditë lirohet në shtëpi.

- me çka ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr.6 lidhur me paragr.1 KPRK

Gjykata duke iu referuar dispozitave të nenit 4,41,42,49,50,51,52,73 dhe 74 KPRK si dhe nenit 248 dhe 365 KPPRK, i shqipton

DËNIMIN ME KUSHT

I. Dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3(tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1(një) viti nuk kryen tjetër veprë penale, me ç’rast dënimi me kusht do të revokohet.

II. I dëmtuari B.Sh. nga Gjilani, rr. “ ... ” për realizimin e kërkesë pronësore-juridike është udhëzuar në kontestin civil.

III. I akuzuari obligohet që në emër të paushallit të paguaj shumën prej 25 € si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, në afat prej 15 ditësh.

IV. I akuzuari obligohet që në bazë të nënparagr.3.1 të Ligjit mbi Kompensimin e Viktimave të Krimin, në emër të taksës për kompensim, të paguaj shumën prej 30 €.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan ka ngritë aktakuzën kundër të akuzuarit I.S. nga Gjilani, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr.6 lidhur me paragr.1 KPRK.

Gjatë seancës fillestare të mbajtur më dt. 19.09.2018, në të cilën është lexuar aktakuza e prokurorit të shtetit PP.II.nr. 2340/2017 e dt. 13.12.2017, dhe pas leximit të aktakuzës, i pandehuri I.S. deklaroi se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale e cila i vihet në barrë, duke shtuar se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale. Në mbrojtjen e tij, më tutje ka deklaruar se më parë nuk ka qenë i gjykuar, ka gabuar, i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo çfarëdo vepre tjetër penale.

Në seancën e parë fillestare dhe publike, gjykatësja e vetme gjykuese mori Aktvendim me të cilin aprovoi pranimin e fajësisë, pasi që ka konstatuar se për këtë gjë janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore. Gjykatësja e vetme ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi është bërë me vullnetin e tij, se pranimi i fajësisë përmban të gjitha faktet të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë të metë ligjore apo gabime faktike.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës kurse me vetë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, erdhi në përfundim se i akuzuari I.S. ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.paragr.6 lidhur me paragr.1 KPRK.

Me nenin 378.paragr.6 lidhur me paragr.1 KPRK është paraparë që “Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt lëndim të lehtë trupor ose dëm pasuror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet, por nëse vepra është kryer nga pakujdesia, siç është paraparë në paragr.6 të KPRK, do të dënohet me dënimin me gjobë ose me dënimin me burgim deri në 1(një) vit”.

Në bazë të cekurave të mësipërme, gjykata vendosi që të akuzuarin I.S. ta shpallë fajtor për kryerjen e veprës penale, pasi që në veprimet e të njëjtit janë të përmbajtura të gjitha elementet e veprës penale dhe se për këtë është penalisht përgjegjës.

Në bazë të nenit 73 dhe 74 KPRK me rastin e shqiptimit të dënimit kundër të pandehurit, gjyqtarja e vetme gjykuese mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që nga rrethanat lehtësuese gjykata i mori parasysh se është njeri familjar, deri më tani nuk ka qenë i gjykuar, është penduar për kryerjen e veprës penale dhe i premtonte gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla penale apo të ngjashme.

Sipas bindjes së kësaj gjykate shqiptimi i dënimit me kusht ndaj të pandehurit I.S. është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit. Gjykata konstatoi se me këtë lloj të dënimit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit nga neni 41 KPRK që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej vepra tjera penale, t'i parandaloj personat tjerë në kryerjen e veprave penale dhe të paraqes gjykimin shoqëror për veprën penale, të rris moralin dhe fuqizoj obligimin për të respektuar ligjin.

Nga të cekurat e mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.1349/2017 më dt. 19.09.2018

Sekretarja juridike,
Suzana Kovaçeviq

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Snezhana Mihajloviq

UDHËZIMI JURIDIK: *Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në dy kopje dorëzohet përmes kësaj gjykate.*

Përktheu –
Naile Keçmezi

